



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA FUSHË-ARRËZ
KËSHILLI BASHKIAK

Komisioni i Përhershëm i Mirëqenies Sociale Barazisë Gjinore Mosdiskriminimit
dhe të Drejtave të Njeriut

Nr. 2557/3

Prot.



Fushë-Arrëz, më 26.08.2025

RAPORT VENDIMMARRJE

Drejtuar: Këshillit të Bashkisë

Lenda: Vendim për shqyrtimin e projekt vendimit nr. 23, datë 07/08/2025, relacionit e dokumentat shoqërues në lidhje me Projekt vendimin “Për miratimin Planit Vendor për Barazinë Gjinore 2025-2030”

Analiza ligjore Në mbështetje të Ligjit nr. 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", i ndryshuar, Neni 54 "Detyrat dhe kompetencat e Këshillit Bashkiak", pika k "Miraton norma, standarte e kritere për rregullimin dhe disiplinimin e funksioneve që janë dhënë atij me ligj, si dhe për mbrojtjen e garantimin e interesit publik", Ligji nr.9970, datë 24.7.2008 "Për barazinë gjinore në shoqëri", Vendimit nr. 400, date 30.6.2021 "Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Barazinë Gjinore, 2021-2030, dhe të planit të saj të veprimit". Ligji Nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", Ligji Nr. 125/2020 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin Nr. 9669, datë 18.12.2006 "Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare", ndryshuar. Ligji Nr. 124/2020 Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr. 10221/04.02.2010 "Për mbrojtjen nga diskriminimi", I ndryshuar. Ligji Nr. 35/2020 "Për një ndryshim në ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995, "Kodi Penal I Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar. Ligji Nr. 136/2015 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995 "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar. Ligji Nr.

93/2014 "Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara". Ligji Nr.104/2014 "Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr. 7703, datë 11.05.1993 "Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, Ligji Nr. 101/2020 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin Nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, Ligji Nr. 69/2012 "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, Ligji Nr. 121/2016 "Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, Ligji Nr. 65/2016 "Për ndërmarrjet sociale në Republikën e Shqipërisë", Ligji Nr. Penale", i ndryshuar, Ligji Nr. 79/2017 "Për sportin", Ligji Nr. 22/2018 "Për strehimin social" i ndryshuar, Ligji Nr. 15/2019 "Për nxitjen e punësimit" i ndryshuar, Ligji Nr. 75/2019 "Për rininë" i ndryshuar.

Situata aktuale e funksionit: Parimet që udhëheqin zbatimin e PVVBGJ, janë të njëjtat parime që udhëheqin në tërësi dhe zbatimin e Kartës Evropiane për Barazi të grave dhe burrave në jetën vendore, sic paraqiten në vijim:

1. Barazia ndërmjet grave dhe burrave, të rejave dhe të rinjve, vajzave dhe djemve nga gjithë grupet, përbën një të drejtë themelore. 2. Për të siguruar barazinë gjinore duhet të trajtohen çështjet e diskriminimit dhe të pengesave të shumëfishta. Pjesëmarrja e balancuar e grave dhe burrave, të rejave dhe të rinjve në vendimmarrje është parakusht për një shoqëri demokratike. 4. Eliminimi i stereotipave gjinorë ka rëndësi themelore për arritjen e barazisë gjinore. 5. Integrimi i këndvështrimit gjinor në të gjitha veprimtaritë e organeve të vetëqeverisjes vendore është i nevojshëm për të cuar përpara barazinë gjinore. 6. Planet e veprimit, të mbështetura me burimet e duhura, janë instrumente të nevojshme për cuarjen përpara të barazisë gjinore.

Fushat kryesore të ndërhyrjes: PVVBGJ 2025-2030, përbëhet nga katër fusha kryesore të ndërhyrjes, të cilat jo vetëm kanë në përmbajtje nene të ndryshme të Kartës Evropiane për Barazi, por janë harmonizuar edhe me një pjesë të objektivave specifike të Strategjisë Kombëtare për Barazinë Gjinore 2021-2030, sidomos ato që përmbajnë masa dhe veprime specifike ku përgjegjës kryesorë për zbatim janë NJVV-të. Këto fusha ndërhyrjeje janë: 1. Promovimi i të drejtave ekonomike, sociale dhe të punësimit të denjë, si dhe fuqizimi i vajzave, të rejave dhe grave. 2. Rritja e pjesëmarrjes dhe përfaqësimi i grave dhe të rejave/ të rinjve në vendimmarrje. 3. Liri nga të gjitha format e dhunës me bazë gjinore. 4. Integrimi gjinor në politikat vendore.

Drejtoria / Sektori përgjegjës:

Drejtoria e Çështjeve Sociale ka relatuar përpara komisionit për Projekt Vendimin.

Monitorimi dhe raportimi : Komisioni i Përhershëm i Mirëqenies Sociale Barazisë Gjinore Mosdiskriminimit dhe të Drejtave të Njeriut dhe të gjithë këshilltarët do të monitorojnë zbatimin e buxhetit dhe do të thërrasin sa herë të jetë nevojshme Drejtoria e Çështjeve Sociale për zbatimin e projektit.

Impakti social / grupet që preken: Impakton jetën të gjitha nënat, grate dhe vajzat në të gjithë territorin të bashkisë

A është objekt i konsultimit publik: Eshte objekt konsultimi publik dhe konsultimi me publikun eshte mbajtur me date 25 Gusht 2025.

Komisioni i Përhershëm i Mirëqenies Sociale Barazisë Gjimore Mosdiskriminimit dhe të Drejtave të Njeriut, i mbledhur me datën 26/08/2025, shqyrtoi projekt vendimin “Për Miratimin e Planit Vendor për Barazinë Gjimore 2025-2030” paraqitur nga Kryetari i Bashkisë.

Pas shqyrtimit të projekt vendimit dhe materialeve shoqëruese,

Komisioni me shumicë votash,

VENDOSI

1. T’i propozojë Këshillit Bashkiak:
 - a) kalimin e projektaktit në Mbledhjen e Këshillit për vlerësim të mëtejshëm dhe shqyrtim
 - b) miratimin e projektaktit

Bashkëlidhur **argumentat e vendimmarrjes dhe mendimi i pakicës** i paraqitur në Relacionin e mbledhjes së Komisionit

Franc Doda  Kryetar i Komisionit
(emri, mbiemri, firma)

Pavlin Qafa  Sekretar i Komisionit
(emri, mbiemri, firma)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA FUSHË-ARRËZ
KËSHILLI BASHKIAK

**Komisioni i Përhershëm i Mirëqenies Sociale Barazisë Gjinore Mosdiskriminimit
dhe të Drejtave të Njeriut**

Nr. 2557/3 prot.

Fushë-Arrëz, më 26.08.2025

PËR : KËSHILLIN E BASHKISË

FUSHË-ARRËZ

Lënda: Relacion mbi Projektvendimin për **Planin Vendor të Barazisë Gjinore 2025-2027** për Bashkinë Fushë-Arrëz, që do t'i paraqitet Këshillit të Bashkisë për shqyrtim në mbledhjen e tij të datës 27.08.2025.

Në zbatim të ligjit 139/2015 "Per vetëqerisjen vendore", i ndryshuar; Rregullores për Funkcionimin e Këshillit të Bashkisë, Komisioni i Përhershëm i Mirëqenies Sociale Barazisë Gjinore Mosdiskriminimit dhe të Drejtave të Njeriut në mbledhjen e datës 26.08.2025 me pjesëmarrjen e anëtareve: Franc Doda, Pavlin Qafa dhe Tereze Dema, mori në shqyrtim Projektvendim për Planin Vendor të Barazisë Gjinore 2025-2027 për Bashkinë Fushë-Arrëz, paraqitur nga Sektori i Shërbimit Social.

Sidorela Katroshi, Drejtoreshë per Çështjet Sociale, thote se:

“ Gratë dhe burrat, të rejtat e të rinjtë, vajzat dhe dhe djemtë e Fushë-Arrëzit, pavarësisht moshës, vendbanimit, grupit etnik e social, aftësive të kufizuara e nevojave të vecanta, statusit civil, statusit të punësimit e gjendjes ekonomike, përkatësisë fetare, apo karakteristikave të tjera individuale , gëzojnë, respektojnë dhe kontribuojnë për përparimin drejt barazisë gjinore dhe zbatimin e saj në praktikë, në të gjitha fushat e jetës”

PVVBGJ 2021-2030, përbëhet nga katër fusha kryesore të ndërhyrjes, të cilat jo vetëm kanë në përmbajtje nene të ndryshme të Kartës Evropiane për Barazi, por janë harmonizuar edhe me një pjesë të objektivave specifike të Strategjisë Kombëtare për Barzinë Gjinore 2021-2030, sidomos ato që përmbajnë masa dhe veprime specifike ku përgjegjës kryesorë për zbatim janë NJVV-të. Këto fusha ndërhyrjeje janë:

1. Promovimi i të drejtave ekonomike, sociale dhe të punësimit të denjë, si dhe fuqizimi i vajzave , të rejave dhe grave.
2. Rritja e pjesëmarrjes dhe përfaqësimi i grave dhe të rejave/ të rinjve në vendimmarje.
3. Liri nga të gjitha format e dhunës me bazë gjinore.

4. Integrimi gjinor në politikat vendore.

Secila nga këto fusha të ndërhyrjes është zbërthyer më tej në rezultatet e pritshme, objektivat specifike, treguesit e matjes së tyre, si dhe në masa e veprime konkrete, të cilat drejtohen në matricën e planit të veprimit, ku jepet një informacion më i plotë si për zbatimin dhe vlerësimin e rezultateve, si dhe dokumenteve të tjerë kryesorë ku mund të referohemi, në përmbushje të veprimeve të parashikuara nën secilen fushë ndërhyrjeje.

Përparimi dhe efektiviteti në zbatimin e PVVBGJ kërkon domosdoshmërisht vënien në dispozicion të burimeve të nevojshme dhe të mjaftueshme njerëzore, financiare e infrastrukturore, si dhe kordinimin e veprimeve dhe bashkëpunimin ndërinstitutional me institucionet e tjera vendore, organizatat e shoqërisë civile, bizneset, si dhe organizata ndërkombëtare të cilat punojnë për fuqizim të grave dhe arritjen e barazisë gjinore. Mbledhja dhe përditësimi rregullisht i të dhënave të ndara jo vetëm sipas gjinisë, por edhe sipas një tërësie karakteristikash të tjera individuale, monitorim i vazhdueshëm mbi ecurinë e zbatimit të veprimeve të parashikuara, si dhe transparenca e llogaridhënia për rezultatet e arritura, janë gjithashtu domosdoshmëri për të përparuar drejt vizionit që udhëheq këtë PVVBGJ.

Pa asnjë diskutim anëtarët e komisionit rane dakord me **shumicë votash** duke e derguar projektvendimin për shqyrtim të metejshëm dhe miratim në mbledhjen Plenare të datës 27.08.2025.

Duke kërkuar bashkëpunimin tuaj!

PER KOMISIONIN

Franc Doda



Pavlin Qafa

